

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas **Shtojcës 1**.

b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar sipas **Shtojcës 2/1**;

c. Lista e informacionit konfidencial sipas **Shtojcës 5**

ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas **Shtojcës 6**;

d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas **Shtojcës 7**;

dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas **Shtojcës 8/1**;

e. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri, për muajin Mars 2021.

(Shënim: Mos shlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveçrastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë).

Shënim*: OE/BOE ofertues, në rastin që oferton me më shumë se një prodhues, duhet të saktësojë (përcaktojë) sasinë që do të sjellë për të përmbushur kontratën.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

a) Kopje të çertifikuara të bilanceve të tre viteve te fundit (**2017, 2018, 2019**) të operatorit ekonomik pjesmarrës, të paraqitura në autoritetet përkatëse dhe të konfirmuara nga ky autoritet.

b) Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjate 3 (tre) viteve te fundit (**2017, 2018 dhe 2019**) ku vlera mesatare e tyre te jete **sa 40% i vleres se fondit limit*** e objektit te prokuruar.

2.3 Kapaciteti teknik:

a) Dëshmi nga operatori ekonomik per furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë **sa 40% e vleres së fondit limit*** të kontratës që prokurohet dhe qe eshte realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit te tenderit.

– Si dëshmi për përvojën e mëparshme me nje ent publik, kërkohet kontrata/kontratat perkatese te shoqeruara me vërtetimin e realizimit me sukses te saj/te tyre.

– Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore te shitjes ku te shënohen qarte datat, shumat dhe sasi të e mallrave të furnizuara.

b) Kërkohet deklarate e ofertuesit mbi origjinen e mallit (vendi i prodhimit dhe kompania prodhuese) per secilin artikull; per plotësimin e afatit te skadences se tyre, si dhe respektimit te specifikimeve teknike te kërkuara nga shërbimi mjekesor.

c) Për të gjithë artikujt e ofruar te paraqiten katalogje, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike te hollësishme për secilin artikull (*pjeset e katalogut qe permbajne emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike te artikullit qe ofertohe, nese nuk jane ne gjuhen shqipe, te perkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen*). Operatori ekonomik duhet te markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor (**te markuara sipas artikullit**) te percaktuar ne formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit.

ç) Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese Autorizim te leshuar nga Prodhuesi ose Distributori Zyrtar i Autorizuar/MAH/*(ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin)* nëpërmjet te cilit konfirmohet se autorizohet të tregtoje materialet mjekesore objekt prokurimi. Autorizimi duhet te jete i vlefshem ne momentin e hapjes dhe dorëzimit te ofertave; dhe origjinale ose fotokopje te perkthyer dhe te noterizuara.

d) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese çertifikatën **ISO 9001:2015** mbi “*Sistemet e menaxhimit të cilësisë*”, me objekt aktiviteti te certifikates per tregetim të materialeve mjekësore në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

dh) Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesi Certifikaten **ISO 9001:2015** mbi “*Sistemet e menaxhimit të cilësisë*” ose **EN ISO 13485:2016** mbi “*Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore*” ose **SSH EN ISO 13485:2016** mbi “*Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore*”, të prodhuesit, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

e) Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese autodeklarate për materialet mjekesore nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) per konformitetin me normat **MDD 93/42/EEC** ose **98/79 EC**, ose **2015/1535/EU**, kur eshte e aplikueshme, sipas **Direktivave dhe klasifikimit te Keshillit te Europes**, bashkëlidhur me kopjet te certifikatave perkatese **CE/DC (Deklarate konformiteti)**, origjinale, ose fotokopje te perkthyer dhe te noterizuara, te vlefshme ne momentin e hapjes dhe dorëzimit te ofertave.

Shënim: KVO rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesit.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Njesia e Prokurimit

Marisa Mezini Juriste

Tatjana Polo Ekonomiste

Irma Perdoj Juriste